



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 104, Datë 23.05.2025

MBI

**ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S LIDHUR ME SHQYRTIMIN
E KËRKESËS SË SHOQËRISË “SPV BLUE 2” SH.P.K. PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.05.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1496/1 prot., datë 21.05.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të këtij Aplikimi janë ndjekur procedurat dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Paraqitja e Kërkesës për Licencim

- Shoqëria “SPV BLUE 2” sh.p.k. ka paraqitur në ERE kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike më 10.04.2025 dhe më pas, më 15.04.2025, ka dorëzuar mandatin e pagesës, duke shënuar fillimin e llogaritjes së afatit të shqyrtimit të aplikimit.

2. Fillimi i Procedurës së Licencimit

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 83, datë 24.04.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- Në datat 25.04.2025 dhe 26.04.2025, ERE publikoi njoftimin për fillimin e procedurës në median e shkruar dhe në faqen zyrtare të internetit.
- Deri më datë 05.05.2025, datë kur përfundoi afati për paraqitjen e komenteve apo objeksioneve nga të tretët, nuk rezultoi të ketë patur të tilla.

3. Kërkesa për Dokumentacionin Plotësues

- ERE me shkresën nr. 1496/4 prot., datë 30.04.2025, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës së licencimit, si dhe i ka bërë me dije dokumentacionin që nevojitet të plotësohet në këtë aplikim.

4. Dorëzimi dhe Vlerësimi i Dokumentacionit Plotësues

- Më 05.05.2025, shoqëria dorëzoi në ERE dokumentacion shtesë për aplikimin, si në mënyrë elektronike ashtu edhe fizike. Pas shqyrtimit, ERE kërkoi sqarime dhe dokumentacion shtesë për mbështetjen financiare dhe planin e biznesit. Në përgjigje, më 19.05.2025, shoqëria dorëzoi planin e biznesit të përditësuar dhe kërkoi disa ditë shtesë për dorëzimin e dokumentacionit financiar.

5. Shtyrja e Afatit të Vendimmarrjes

- Referuar nenit 14, pika 3 të Rregullores, bordi i ERE-s mund të zgjatë afatin e vendimmarrjes deri në 30 ditë, kur dokumentacioni nuk është i plotë.
- Për gjithë sa më sipër, vlerësohet të pranohet kërkesa e shoqërisë dhe të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së bordit të ERE-s për aplikimin e kësaj shoqërie për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin e munguar brenda 20 (njëzet) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “SPV BLUE 2” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
2. Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin e munguar brenda 20 (njëzet) ditëve.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “SPV Blue 2” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI